REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr./Br. 964/20
Datë/Datum. 10.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.964/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Nuhi Paçarizi - Kryetar, Blerim Dina - Referues, Goran Milenković- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik N.T.SH "Europa"-Prishtinë, kundër njoftimit për anulim të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Servisimi dhe mirëmbajta e automjeteve për nevojat e Agjencive të Pavarura Lot 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12,13,14,15,16" me nr. të prokurimit: UA-20-3658-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-"Agjencia Qendrore e Prokurimit", më datën: 09.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **REFUZOHET**, si e pa bazuar ankesa e operatorit ekonomik N.T.SH "Europa"-Prishtinë, kundër njoftimit për anulim të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Servisimi dhe mirëmbajta e automjeteve për nevojat e Agjencive të Pavarura Lot 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16" me nr. të prokurimit: UA-20-3658-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-"Agjencia Qendrore e Prokurimit".

II. **VËRTETOHET**, njoftimi për anulim të kontratës i AK-së, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Servisimi dhe mirëmbajta e automjeteve për nevojat e Agjencive të Pavarura Lot 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12,13,14,15,16" me nr. të prokurimit: UA-20-3658-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-"Agjencia Qendrore e Prokurimit".

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: N.T.SH "Europa"-Prishtinë, i refuzohet si e pa bazuar, i bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues N.T.SH "Europa"-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 17.11.2020 me nr. 964/20, kundër njoftimit për anulim të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Servisimi dhe mirëmbajta e automjeteve për nevojat e Agjencive të Pavarura Lot 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12,13,14,15,16" me nr. të prokurimit: UA-20-3658-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-"Agjencia Qendrore e Prokurimit" duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 59 dhe 61 të LPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 23.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 27.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimin nr. 1: Për pretendimin e OE ankues, se autoriteti kontraktues ka veprua pa baze ligjore dhe ne kundërshtim me nenin 1, 59 dhe 61 te LPP-se duke e anuluar këtë aktivitet te prokurimit për çmime jo normalisht te ulëta edhe pse ne kemi dhënë arsyetime bindëse duke dëshmuar me prova konkrete se çmimet tona te dhëna ne oferte janë reale dhe se me këto çmime do ta realizojmë kontratën duke pasur për baze se me çmime te ngjashme kemi realizuar edhe kontrata te tjera, eksperti shqyrtues ka këtë mendim. Gjatë procesit të ekzaminimit vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, autoriteti kontraktues në përputhje me neni 61 të LPP-së dhe neni 4 të Rregullave për tenderët jo normalisht të ulët (B57) ka kërkuar sqarime shtesë për çmimet e dhëna në ofertë për disa pozicione prej OE ankues. Në kuadër të këtij sqarim autoriteti kontraktues ka kërkuar prej OE ankues shpjegime detale te elementeve përbërëse të tenderit për ato pozicione që kanë çmime jo normalisht të ulëta në krahasim me çmimet e tregut. Lidhur me këtë kërkesë të AK, OE ankues është përgjigjur duke u zotuar se çmimet i kemi kalkuluar dhe i kemi vendosur në dosjen e tenderit dhe si të tilla janë reale dhe nuk do të paraqesin problem në implementim të kontratës. Kësaj përgjigje OE ankues i ka bashkangjitur edhe disa çmime të pjesëve me të cilat furnizohet nga Auto Zonë "BREYKO". Me gjithë përgjigjen e dhënë nga OE ankues për autoritetin kontraktues, ky i fundit nuk është bindur që arsyetimi i dhënë dhe dëshmitë e ofruara garantojnë implementim të rregullte të kontratës. Nga kjo që u tha më lartë, mos bindja e autoritetit kontraktues, a është shkelje e nenit 61 të LPP-së dhe Rregullave për tenderët jo normalisht të ulët për të cilën pretendon OE ankues, këtë situatat e shpjegon po ashtu neni 61 pika 4 e LPP-së e cila thotë: "Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe sqarimeve të dorëzuara nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues vendos se tenderi është jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të refuzojë tenderin" Nga kjo dispozitë, ligji i prokurimit publik i jep të drejtë dhe kompetencë autoritetit kontraktues që të vendos nëse tenderi ka çmime jo

normalisht të ulëta ose jo. Pra është kompetencë ekskluzive e AK të jep vlerësimin për këtë çështje. Bazuar në disa çmime që eksperti shqyrtues i nxjerrë nga oferta e OE ankues për disa pozicione si p.sh: Cilindri Kryesorë për Skoda Yeti 2000 cc, çmimi 0,10 € Kushineta Mbajtëse për Skoda Yeti 2000 cc, çmimi 0,10 € Ftohësi i Turbinës për Skoda Yeti 2000 cc, çmimi 0,10 € etj. Shihet çarte qe për këto pozicione edhe shume pozicione te tjera te ngjashme, nuk janë çmime tregu, respektivisht janë çmime jo normalisht te ulëta. Mbi këtë baze eksperti shqyrtues beson se vlerësimi i autoritetit kontraktues për ta trajtuar ofertën me çmime jo normalisht te ulëta ka qene i drejte dhe ne përputhje me nenin 61 te LPP-se. Fakti qe edhe ofertat e tjera kane çmime te ngjashme dhe te njëjta janë eliminuar për këtë arsye, rrjedhimisht ofertat kane qene te papërgjegjshme. Mungesa e ofertave të përgjegjshme ka rezultuar me anulim te aktivitetit te prokurimit e qe ka qene ne përputhje me dispozitat e LPP-se. Prandaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues : Autoriteti kontraktues ka bere ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave dhe ka rezultuar se te gjitha ofertat kane çmime jo normalisht te ulëta, prandaj ofertat kane përfunduar si te pa përgjegjshme. Duke pasur për baze çmimet e dhëna ne disa pozicione te ofertës se OE ankues te cilat janë te ulëte përtej çmimeve reale te tregut, eksperti shqyrtues vlerëson se vendimi i autoritetit kontraktues për anulim te aktivitetit te prokurimit ka qene i drejtë dhe ne përputhje me dispozitat e nenit 62 te LPP-se. Nuk qëndrojnë pretendimet e OE ankues për shkeljet te neneve te LPP-se te përmendura ne ankese. Nga sqarimet te cilat u përshkruan me larte, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e Operatorit Ekonomik ankues të refuzohet si e pa bazuar. Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së, rekomandon autoritetin kontraktues që të **te** mbaje ne fuçi vendim për anulim lidhur me aktivitetin e prokurimit për "Servisimi dhe mirëmbajtja e klimave për nevojat e Agjencive te Pavarura" me nr. prokurimi UA/2016-20-3748-2-2-1 dhe nëse shpreh interesim edhe me tutje për këtë aktivitet te prokurimit ta **Ri tenderoj** atë.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 27.11.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti kontraktues me datë 01.12.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, N.T.SH "Europa"SH.P.K- Prishtinë, me datë: 29.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk-pajtohen me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Te nderuar ne kemi pranuar ekspertizën e ekspertit te OSHP-se nr. 964-20. Natyrisht qe ne si **OE** nuk pajtohemi me mendimin e tij. N.T.SH EUROPA ka bere ankese për ketë aktivitet prokurimi dhe gjitha pretendimet tona ankimore konsiderojmë qe janë plotësisht te argumentueshme dhe si te tilla shpresojmë qe paneli shqyrtues ti marr parasysh. Ne kemi sqaruar mjaftë dhe arsyeshëm përshkrimin e çmimeve duke e

dëshmuar qe ne furnizohemi me ato pjese nga AUTO ZONE BREYKO si dëshmi ne ankesë e keni ofertën nga kjo kompani për N.T.SH EUROPA.

VEMENDJE : N.T.SH EUROPA edhe me herët kemi bere ankese për një aktivitet te prokurimit nr. 528,541/20 e ku ne si operator ekonomik kemi qene me te shtrenjtë ne raport me OE te rekomanduar për kontratë . Çmimet qe OE i rekomanduar për kontratë i ka me te lira se sa ne kemi ofertuar ne AQP, e qe ankesa jone për ketë aktivitet prokurimi nuk është aprovuar . Kemi bere këtë krahasim për arsye se ne si OE jemi duke u dëmtuar nga autoritetet kontraktues ku për çështje te njëjta disa operator ekonomik shpallen fitues e disa te tjerë eliminohen. Kërkojmë nga OSHP-ja qe ta aprovon ankesën tone si te bazuar dhe lenden ta kthen ne rivlerësim dhe kërkojmë edhe një here qe ti ketë parasysh paneli shqyrtues pretendimet tona ankimore se bashku me dëshmi qe i kemi deponuar ne ankese.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 09.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka vepruar pa bazë ligjore dhe në kundërshtim me nenin 1, 59 dhe 61 të LPP-së duke e anuluar këtë aktivitet të prokurimit për çmime jo normalisht të ulëta edhe pse ne kemi dhënë arsyetime bindëse duke dëshmuar me prova konkrete se çmimet tona të dhëna në ofertë janë reale dhe se me këto çmime do ta realizojmë kontratën duke pasur për bazë se me çmime të ngjashme kemi realizuar edhe kontrata të tjera.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se gjatë procesit të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, autoriteti kontraktues në përputhje me neni 61 të LPP-së dhe neni 4 të Rregullave për tenderët jo normalisht të ulët (B57) ka kërkuar sqarime shtesë për çmimet e dhëna në ofertë për disa pozicione prej OE ankues. Në kuadër të këtij sqarimi, autoriteti kontraktues ka kërkuar prej OE ankues shpjegime detale të elementeve përbërëse të tenderit për ato pozicione që kanë çmime jo normalisht të ulëta në krahasim me çmimet e tregut. Lidhur me këtë kërkesë të AK, OE ankues është përgjigjur duke u zotuar se çmimet i kemi kalkuluar dhe i kemi vendosur në dosjen e tenderit dhe si të tilla janë reale dhe nuk do të paraqesin problem në implementim të kontratës. Kësaj përgjigje OE ankues i ka bashkangjitur edhe disa çmime të pjesëve me të cilat furnizohet nga Auto Zonë "BREYKO". Me gjithë përgjigjen e dhënë nga OE ankues për autoritetin kontraktues, ky i fundit nuk është bindur që arsyetimi i dhënë dhe dëshmitë e ofruara garantojnë implementim të rregullt të kontratës. Nga kjo që u tha më lartë, mos bindja e autoritetit

kontraktues, a është shkelje e nenit 61 të LPP-së dhe Rregullave për tenderët jo normalisht të ulët për të cilën pretendon OE ankues, këtë situatatë e shpjegon po ashtu neni 61 pika 4 e LPP-së e cila thotë: "Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe sqarimeve të dorëzuara nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues vendos se tenderi është jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të refuzojë tenderin" Nga kjo dispozitë, ligji i prokurimit publik i jep të drejtë dhe kompetencë autoritetit kontraktues që të vendos nëse tenderi ka çmime jo normalisht të ulëta ose jo. Pra është kompetencë ekskluzive e AK të jep vlerësimin për këtë çështje. Paneli Shqyrtues sqaron se eksperti shqyrtues i ka nxjerrë disa çmime nga oferta e OE ankues për disa pozicione, si p.sh: Cilindri Kryesorë për Skoda Yeti 2000 cc me çmim 0,10€, Kushineta Mbajtëse për Skoda Yeti 2000 cc me çmim 0,10€, Ftohësi i Turbinës për Skoda Yeti 2000 cc me çmim 0,10€, etj. Shihet qartë që për këto pozicione edhe shumë pozicione të tjera të ngjashme, nuk janë çmime tregu, respektivisht janë çmime jo normalisht te ulëta.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyertues, vjen në përfundim se AK e ka anuluar këtë aktivitet në harmoni me nenin 62 të LPP-së sepse në disa pozicione OE ka ofruar me çmime jo normalisht të ulëta dhe AK me të drejt e ka trajtuar si tender jo normalisht i ulër. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues sqaron se vlerësimi i autoritetit kontraktues për ta trajtuar ofertën e OE ankues me çmime jo normalisht te ulëta ka qene i drejtë dhe në përputhje me nenin 61 te LPP-se. Fakti që edhe ofertat e tjera kanë çmime të ngjashme dhe të njëjta janë eliminuar për këtë arsye, rrjedhimisht ofertat kanë qenë të papërgjegjshme. Andaj, mungesa e ofertave të përgjegjshme ka rezultuar me anulim të aktivitetit të prokurimit e që ka qenë në përputhje me dispozitat e LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Paneli Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "Agjencia Qendrore e Prokurimit";

1x1 OE N.T.SH"Europa" SH.P.K-Prishtinë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.